



## **V E N D I M**

**Nr. 259, datë 09.05.2018**

### **P Ë R**

### **MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018-2024 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr.115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 – 2024 dhe të planit të veprimit të saj, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**